

Llaç çimentoje me rezistencë të lartë i përforcuar me fibra

Përshkrimi

Llaç meremetues prej çimentoje me rezistencë të lartë, i përforcuar me fibra dhe i pasuruar me polimere. Ai ofron:

- Rezistencë të jashtëzakonshme.
- Ngjitje shumë të mirë me nënshtresën.
- Punueshmëri të shkëlqyer.
- Depërtueshmëri të reduktuar të ujit.
- Qëndrueshmëri të vëllimit.

Fushat e përdorimit

MEGACRET-40 është i përshtatshëm për riparimet me kërkesa të larta në elementet e betonit. Ai aplikohet me një mistri ose me pompë në dysheme, mure ose tavane.

Të dhënat teknike

Trajta:	pluhur çimentoje
Ngjyra:	gri
Uji që nevojitet:	4,60 kg për një thes 25 kg
Densiteti i volumit të llaçit të thatë:	1,47 ± 0,20 kg/litër
Densiteti i volumit të llaçit të njomë:	2,00 ± 0,20 kg/litër
Rezistenca në shtypje:	
• Pas 24 orësh:	22,00 ± 5,00 N/mm ²
• Pas 7 ditësh:	40,00 ± 5,00 N/mm ²
• Pas 28 ditësh:	55,00 ± 5,00 N/mm ²
Rezistenca në përkulje:	8,00 ± 1,00 N/mm ²
Koha e punueshmërisë:	2 orë në +20°C
Trashësia maks. për shtresë:	4 cm

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqja duhet të jetë pa pluhur, graso ose materiale të huaja etj. Përpara përdorimit është e nevojshme njomja totale e nënshtresës.

2. Përdorimi

Një thes 25 kg MEGACRET-40 hidhet gradualisht në 4,60 kg ujë duke u trazuar vazhdimisht derisa të krijohet një masë homogjene e lidhur, e përshtatshme për punime meremetimi. Përzierja mund të bëhet duke përdorur një mikser me xhiro të ulëta ose një betoniere të vogël. Materiali duhet të aplikohet (hidhet) me një mistri ose me pompë në trashësinë e dëshiruar, deri në 4 cm për çdo shtresë. Nëse nevojitet një shtresë e dytë, shtresa e parë duhet të jetë bërë e ashpër për të arritur një ngjitje më të mirë.

Sipërfaqja përfundimtare duhet të mbrohet mirë nga dehidratimi duke e mbuluar me leckë të lagura, fletë polietileni ose duke e lagur vazhdimisht gjatë 48 orëve.

Konsumi

Rreth 17,5 kg/m²/cm të trashësisë së shtresës.

Ambalazhimi

MEGACRET-40 ofrohet në thasë letre 25 kg dhe në qese plastike 5 kg.

Magazini

Të paktën 12 muaj në thasë të izoluar dhe në ambiente të thata.

MEGACRET-40



Shënime

- Temperatura gjatë përdorimit duhet të jetë midis +5°C dhe +30°C.
- Në temperatura të ulëta dhe kur kërkohet arritja e shpejtë e fortësisë së materialit, rekomandohet përzierja e materialit me ujë të vakët.
- Produkti përmban çimento, e cila vepron si alkaline me ujin dhe klasifikohet si irritues.
- Ndiqni këshillat e sigurisë dhe masat paraprake të shkruara mbi paketim.



2032

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

10

2032-CPR-10.11

EN 1504-3

Concrete repair product for structural repair CC
mortar (based on hydraulic cement)

DoP No.: MEGACRET-40/1207-03

Compressive strength: class R4

Chloride ion content: $\leq 0.05\%$

Adhesion: ≥ 2.0 MPa

Carbonation resistance: Pass

Elastic modulus: ≥ 20 GPa

Thermal compatibility part 1: ≥ 2.0 MPa

Capillary absorption: $\leq 0.5 \cdot \text{kg} \cdot \text{m}^{-2} \cdot \text{h}^{-0.5}$

Dangerous substances: comply with 5.4

Reaction to fire: Euroclass A1

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dala nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terreneve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

